



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Bilisht, më _____.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Implementim programi për sistemin e taksave dhe të ardhurave vendore

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime për krijim programesh për deklarim taksash 72212412-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,280,000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Devoll**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar .

Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga*

**Bashkia Devoll, Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 5, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail
bashkiadevoll@gmail.com.**

autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 43 pika 1 e cila parashikon se: Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin e shërbimeve të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmitë e mëposhtme:

per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”,

Dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenit 41 pika 3 dhe nenit 55 pika 4 germa b). Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomikë vërtetojnë eksperiencën në fushën e objektit të prokurimit dhe AK merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të kryehet me sukses. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për K për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga OE, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim që të shërbejë autoritetin në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a. ISO 9001: 2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimit që prokurohet.
- b. ISO 27001:2013 (për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit) ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimit që prokurohet.
- c. ISO 20000- 1: 2018 (për Sistemin e Menaxhimit të shërbimeve IT) ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar mbështetur në nenin 79 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët,

mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. si dhe në mbështetje të VKM – së nr. 285, datë 19. 05. 2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”.

Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

ISO 9001: 2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), percaktohet si standart nderkombetar qe specifikon kerkesat per nje sistem te menaxhimit te cilesise, ne menyre qe OE te kene nje sisitem me te mire menaxhimi, planifikim me te mire te aktivitetit, zgjidhje me te shpejte te problemeve, rritje te produktivitetit, fitimeve dhe reputacionit si dhe ndermarja e veprimeve te duhura per te permiresuar vazhdimisht te gjitha aktivitetet e kryera nga OE.

ISO 27001:2013 (për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit) eshte e rendesishme pasi siguron zbatimin e sigurise se informacionit te sherbimeve qe kategorizohen ne kontrate. Per nje sisitem te menaxhimit te sigurise se informacionit qe mund te zbatohet dhe te certefikohet ne cdo shoqeri, pavaresisht nga madhesia e saj dhe pavaresisht nga kategoria e informacionit te perpunuar. Ky standart perqendrohet ne identifikimin dhe vleresimin e rrezeqeve te sigurise dhe zbatimin e kontrolleve te pershtatshme per te mbrojtur informacionin.

ISO 20000 -1 : 2018 (për Sistemin e Menaxhimit të shërbimeve IT) percakton kriteret per planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirembajtjen dhe permiresimin e qasjes se menaxhimit te sherbimeve qe fokusohet ne teknologjine e informacionit. Nje sisitem efektiv i menaxhimit te sherbimit te informacionit kerkon qe biznesi te identifikojë me saktësi nevojat e sigurise, te percaktojë me saktësi nivelin e tolerances se rrezikut dhe te marre nje qasje proaktive ne teknologjine e informacionit. Certifikimi ISO 20000 deshmon qe kompania ofron sherbime te teknologjise se informacionit te qendrueshme dhe me cilesi te larte, vepron ne perputhje me proceset e identifikuara dhe i kalon me sukses auditimet e nevojshme

Per natyren dhe permasat e objektit te kontrates qe do te prokurohet eshte teper e rendesishme qe operatorët si zbatues te sherbimit te kryejne veprimtarine me standartet e kerkuara te cilesise . Sistemi i cilesise, sigurise se informacionit dhe sherbimit te teknologjise se informacionit jane standart qe cdo subjekt juridik apo privat e ka per qellim me arritjen e suksesit. Keto certefikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontrates dhe nuk perbejne kriterë diskriminuese persa kohe do te pranohen edhe ekuivalente te tyre.

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në

kohë dhe sipas specifikimeve teknike të, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj.) Plotësimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formularëve E-SIG të pakten për muajin e fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nën 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Neni 41 pika 4 e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikon se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”

Ne përcaktimin e numrit të punonjësve Njesia e Prokurimit ka bërë një analizë bazuar tek faktoret dhe kapaciteti i burimeve njerëzore i nevojshëm për instalimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe asistencën që OE do të japë për punonjësit e AK.

Numri prej 3 punonjësish është mesazhi i nevojshëm për të zbatuar kontratën me cilësi, korektesi dhe sipas specifikimeve dhe shërbimeve të kërkuara në DT.

Ky numër punonjësish dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për AK se OE do të përmbushë kontratën brenda afatit të caktuar dhe me cilësi. Kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës dhe për rrjedhojë litempagesat janë dokument

vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve dhe pervojen e tyre, persa kohe qe ato jane ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me natyren e kontrates.

Punesimi i nje numri te caktuar dhe me kohe te plote pervec besueshmerise se OE si je nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikat soviale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes/.

Kriteri për 3 (tre) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatikë ekonomike, shkenca kompjuterike etj.), është në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi përfshin zbatimin, integrimin, menaxhimin dhe sigurinë e të gjitha informacioneve teknike të sistemit dhe të të dhënave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 10, te DST. Dokumentat e kerkuara me siper do te paraqiten nga OE i kualifikuar ne vend te pare perpara publikimit te njoftimit paraprak te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. per ofrim zgjidhje software per fiskalizim ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.

-Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorzimin e certifikates se leshuar nga AKSHI dhe DPT.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 41, pika 4, germa “a”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT